

VENDIM
Nr.856, datë 5.8.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË NË
“GJUHË-LETËRSI SHQIPE DHE FRËNGE”, NË UNIVERSITETIN “FAN S.
NOLI”, TË KORÇËS**

(Ndryshuar me VKM nr. 977, datë 8.10.2009)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. *Hapjen në universitetin “Fan. S. Noli” të Korçës, në fakultetin e mësuesisë, të programit të studimit “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të parë (DNP), në “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge”.*

2. Ky program studimi i ciklit të parë realizohet me 180 kredite ECTS dhe kohëzgjatja normale është 3 (tri) vite akademike.

3. Në përfundim të këtij programi studimi përfitohet “Diplomë e nivelit të parë” DND, në “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge”.

3/1. *Kuota e pranimit në programin e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, në “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge” është 50 (pesëdhjetë).*

4. Ky program studimi do ta fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4/1. *Tarifa e shkollimit në programin e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, në “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge” është 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë.*

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin “Fan S. Noli” të Korçës.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Fan S. Noli” të Korçës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha